

**Bashkë për jetë më të mirë dhe shoqëri më të drejtë!**

**Iniciativa qytetare evropiane**

**Fushata në industrinë e transpordit**

**2**

**Një gjest i vogël njerëzor**

**Apeli për pranimin e 50 000 refugjatëve**

**3**

**Iniciativa federale AHV/AVSplus**

**Për pensione më të mira dhe të dinjitetshme!**

**4**



Nr. 3 | mund 2016 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

**Ofensiva e natyralizimit**

## Ne jemi Zvicra (e re)!



Shumëllojshmëria dhe jetësimi i të drejtave për të gjithë paraqet pasuri për Zvicrën

**Ju si fëmijë të migrantëve e migrantëve; fëmijët e juaj, të cilët janë lindur këtu dhe gjegjësisht janë rritur këtu; Vetë ju, që jetoni me dekada të tëra: ju të gjithë keni bashkë-ndërtuar, bashkë-paguar dhe keni bashkë-ndikuar shoqërinë zvicerane. Andaj edhe ju të gjithë jeni pjesë e kësaj Zvicerë të re dhe për këtë arsye keni edhe të drejta! Ne ketë e përsërisim pandërprerë. Një çështje kjo e barazisë por edhe e dinjitetit: Jo vetëm se të gjithë ata që kanë mundësi duhet të shfrytëzojnë të drejtën dhe të marrin shtetësinë – porse edhe zyrtarët duhet më në fund të pranojnë se ne të gjithë jemi pjesë e vendit dhe shoqërisë zvicerane!**

Përse duhet të merrni shtetësinë? Ndoshta e shtroni pyetjen përse duhet pikërisht unë. Po përse nuk do të duhej? Është një e drejte e juaja! Ashtu si shkruan kryetarja e jonë Vanja Alleva në editorialin e këtij numri të Horizontit: Ju bashkë-ndërtoni këtë vend, ju paguani tatimin, fëmijët e juaj shkojnë këtu në shkollë, ju ndoshta jetoni edhe gjatë tërë jetës suaj këtu. Dhe juve u thonë se nuk i takoni (edhe) këtij vendi?! Gabim, ju i takoni kësaj shoqërie edhe nëse vini nga një vend tjetër apo vende tjera, të cilat i cilësoni si vend amë (Atdhe). Ju keni të drejta: për të bashkë-vendosur, për shembull se për çka duhet të shërbejnë paratë që ju paguani në formë tatimi. Ju keni të drejtën të guxonit të qëndroni këtu dhe të mos jeni të detyruar të lëshoni

këtë vend, vetëm pse keni humbur vendin e punës dhe vetëm pse keni bërë ndonjë gabim të vogël. Marrja e shtetësisë do t'ju mundësonte pjesëmarrjen në vendime dhe do të fitonit sigurinë e qëndrimit. Pasi faktikisht siguria e qëndrimit dhe të drejtat e juaja realisht dhe janë të rrezikuara fort nga aprovimi i të ashtuquajturës «Iniciativë mbi migrimin masiv».

### Të demokratizojmë Zvicrën!

Ne duhet të demokratizojmë Zvicrën. Nuk është në rregull që çereku i popullatës së Zvicrës të mos mund të merr pjesë dhe të bashkëveproi. Këtë duhet ta ndryshojmë ne, andaj për këtë arsye kryesia e Bashkimit të Sindikatave të Zvicrës (SGB/USS) planifikon një ofensivë natyralizimi. Kjo ofensivë parasheh posaçërisht



Pasaporta garanton të drejtat dhe pjerëmarrjen politike!

edhe punën lobuese nëpër qytete e komuna: këto duhet të ftojnë në mënyrë ofensive migrantët dhe fëmijët e tyre që të marrin shtetësinë. Ata duhet të cytin dhe ti motivojnë migrantët, para se gjithash atyre duhet tu ndërmjetësojnë ndjenjën se janë pjesë e jona. Ata nuk duhet të vejnë edhe më shumë pengesa në rrugë dhe të definojnë «kriteret» jo relevante, apo që të rrisin koston e taksave për natyralizim.

### Bëhuni tani zviceran/e

Ashtu si kemi raportuar në numrin 7/2015 të Horizontit, nga viti 2017 do të ndryshojë ligji për natyralizim i Zvicrës. Marrja e shtetësisë do të vëzhgohet. Jo vetëm se do të duhet të dëshmojnë njohuri më të mira gjuhësore, por edhe duhet të posedoni

lejen e qëndrimit C si parakusht për të aplikuar për marrje shtetësie. Ju pos tjerash do të duhet të plotësoni edhe kriteret tjera të fryra integruese, të cilat pjesërisht do të jenë më të ngurrëta, si fjala bie pjesëmarrja në «jetën ekonomike». Nëse ju në të kundërtën aplikoni qysh në vitin 2016, gjegjësisht para hyrjes në fuqi të ligjit të ri të natyralizimit, atëherë për të marrë shtetësinë vlejnë kriteret në bazë të ligjit të vjetër.

### Të shfrytëzojmë tani këtë hapësirë

Ne si Unia duam që anëtarët tanë, të cilët duan të marrin shtetësinë ti mbështesim konkretisht. Duke i informuar ata se si funksionon procedura e marrjes së shtetësisë, apo edhe ti ndihmojmë në rast pyetjesh. Ne duam mundësisht të ndihmojmë edhe rreth kërkesave gjuhësore dhe tekstit integruese. Në këtë rrafsh vlen të planifikojmë më shumë bashkë me partnerët tanë. Ftesë për të gjithë ju: Nëse i plotësoni kriteret atëherë merrni shtetësinë: vetë ju, partneri juaj, fëmijët tuaj. Për të drejtat tuaja, për të mirë të shoqërisë zvicerane dhe kështu për të gjithë ne!

### Editorial



### Merrni të drejtat e juaja – merreni shtetësinë!

Ka vite që përjetojmë sulmet kundërt të drejtave të migrantëve. Pika më e ulët u arrit me rastin e «Iniciativës së SVP/UDC për zbatim të dëbimit», e cila donte të dëbonte me forcë të huajt edhe në raste të kundërvajtjes. Edhe falë nesh populli më 28.2.2016 tha «stop».

Koha për një kundëroffensivë për të drejta të njëjta ka ardhur. Ne po e nisim me një ofensivë natyralizimi. Përse? Mbi 900 000 njerëz – shumë nga ta sekondar/e (gjeneratë e dytë dhe migrantësh) – përmeshin kushtet për natyralizim, i cili atyre ju bie barazi të plotë. Mirëpo ata nuk po e bëjnë këtë. Ka ardhur koha që kjo të ndryshojë. Ofensiva jonë drejtohet në radhë të parë në drejtim të zyrtarëve të Kantoneve dhe komunave. Ne u themi atyre: Është një certifikatë varfërie për demokracinë tonë, nga e cila sekondat janë të përjashtuar. Ne duam që zyrtarët të kërkojnë të bisedojnë me ta, për t'ju thënë atyre: Ju jeni tanë! Ne kemi interes të madh që ju të angazhoheni politikisht, urdhëroni merreni shtetësinë! Ne do të mundohemi të zvogëlojmë pengesat administrative dhe financiare në këtë rrugëtim.

Ofensiva jonë u drejtohet gjithashtu edhe të gjithë migrantëve/eve, sekondarëve dhe prindërve të tyre. Ne u themi juve: Jeni duke e bashkë-ndërtuar Zvicrën, 1/3 e orëve të punës në vendin tonë kryhen nga ju, ju paguani tatimin e taksat e ndryshme si dhe kontributet e sigurimeve shoqërore. Ju jeni të legjitimuar për bashkë-formësimin e Zvicrës. Angazhohuni e merrni pjesë në sindikata dhe gjithkund ku keni mundësi të ndikoni në të mirë të drejtave tuaja. Dhe nëse ju i keni plotësuar kriteret për natyralizim, merreni shtetësinë, për të fituar mundësinë e të votuarit dhe të zgjedhjes. Mos lejoni që pengesat ekzistuese – edhe nëse këto janë të padrejta – të ju detyrojnë të hiqni dorë! Ne ju ndihmojmë.

**Vanja Alleva**  
Kryetare e sindikatës Unia



News

**Reduktim masiv të pensionit tek Arkat e pensionit**



Shtylla e dytë e sigurimit Pensional është duke shkuar drejt uljeve të mëdha. Kush është aktualisht 50 vjeç duhet të llogarisë me pensione shumë më të ultë se sa është pritur. Këtë e tregon një vlerësim të mbi 60 Arkave të pensionit nga ana e Bashkimit të Sindikatave të Zvicrës (SGB/USS). Zgjidhja e sindikatave për këtë çështje është fuqizimi i shtyllës së parë të sigurimeve shoqërore AHV/AVS përmes iniciativës popullore AHV/AVSplus. Ne një takimin kick-off të para disa javëve me përfaqësuesit e regjioneve të Unias u prezantua projekti i fushatës AHV/AVSplus. Fushata mund të mbështetet dhe në Facebook. Pëiqeje AHV/AVSplus në vegën [www.facebook.com/ahvplus](http://www.facebook.com/ahvplus) dhe ndihmo në përhapjen e fushatës.

**Dumpingu në paga: Shkelësi përsëri mashtron punëtorët**

Në një kantier të Spiez-it në kanton të Bernës Unia ka zbuluar një rast serioz të rëndë të dumpingut në pagë. Veçanërisht problematikë është: Pronari i kantierit është një përsëritës i shkeljeve të kushteve dhe ligjit të punës. Është prekur janë katër punëtorë, të cilët janë mashtruar për 12000 franga në vit. Unia kërkun pagesën retroaktive të pagave korrekte dhe harxhimeve tjera përcjellëse. Më shumë informata mbi këto raste të dumpingut mund të gjeni në vegën: [www.unia.ch/de/aktuell/aktuell/artikel/a/12331/](http://www.unia.ch/de/aktuell/aktuell/artikel/a/12331/) si dhe në dosjen “dumpingu në paga” në vegën e internetit: [www.unia.ch/de/kampagnen/lohndumping/](http://www.unia.ch/de/kampagnen/lohndumping/)

**Shkarkime masive tek Bata**

Grupi Bata është një tregtuesi i madh këpuçesh në Botë me seli në Lozanë. Në mbi 60 vende në tërë botën punojnë më shumë se 34000 të punësuar në 5000 shtatore. Familja pronare Bata banon në Zvicër dhe i takon 300 më të pasurve të vendit. Me një pasuri prej 3.2 miliarda frangave kjo familje posedon me mjete të mjaftueshme për një plan të mirë social. Bata ka ndërmend që në fund të qershorit të mbyll fillalet e sajë në të gjitha regjionet e Zvicrës dhe kështu të shkarkojë personelin. Në ndërkohë edhe kanë ndodhur shkarkimet e para. Si duket Bata në Zvicër dëshiron të koncentrohet në tregtinë-online. Unia kërkun nga tregtarit i madh i këpuçëve transparencë kundrejt punonjëseve, ruajtjen esa më shumë vendeve të mundshme të punës si dhe një plan social korrekt. Familja Bata ka para të mjaftueshme.

14 qershori: 25 vite që nga greva e grave

**Festë dhe luftë e mëtejme!**

**Ka katër dekada që gratë luftojnë për barazi pagash. Megjithatë dallimi mes pagave të burrave dhe grave edhe më tej është 15%.**

2016 për gratë është një vit jubilar: Ligji i barazisë më 1 korrik mbush 20 vjet, përderisa Neni kushtetues mbi barazinë në paga ka hyrë në fuqi para 35 viteve, ndërsa greva e grave në gjithë vendin është zhvilluar para 25 viteve. Këto do të ishin arsye të mjaftueshme për të festuar. Mirëpo asgjë nga këto ende nuk është zbatuar. Andaj festimet jubilarë kanë një shije të hidhur dhe nga ana jonë duhet të shfrytëzohen si shkas për të protestuar.

**Rishikimi i ligjit i barazisë rrezikon të fundoset në balltë** Konsultimi mbi rishikimin e planifikuar të Ligjit të barazisë është duke

hasur në rezistencë të fortë. Nuk është as e sigurte që qeveria federale do ta dërgoj për konsultim politik në parlament. Ekziston rreziku serioz që ky projekt të përfundojnë në sirtar. Kështu ne do të ktheheshim në vitin 2013, para premtimit të bërë nga qeveritarja Simonetta Sammaruga,



Pamje nga manifestimi i ditëve të aksionit në 2015-tën

se barazinë në paga do ta zbatojë përmes kontrolleve të pagave dhe sanksioneve. Vendimi pritet të merret në fund të vitit. Deri atëherë ne duhet të vazhdojmë presionin dhe ta rritim atë, që në vitin 2017 rishikimi i ligjit të dërgohet në konsultim parlamentar.

**Aksione të decentralizuara më 14 qershor**

Disa regjione të sindikatës Unia do të përfshihen në protestë. Mundësisht shumë gra dhe burra solidarë janë të ftuar të marrin pjesë në aksione. Kontaktoni regjionin tuaj dhe informohu se çka është planifikuar në regjioni tuaj për këtë datë.

© Marilia Mendes

**Industria e transportit, Iniciativa qytetare evropiane**

**Po kushteve korrekte në industrinë e transportit!**

**Federata evropiane e punonjëseve të transportit (ETF) ka nisur një iniciativë qytetare evropiane për të tërhequr vëmendjen në kushtet gjithmonë e më të pasigurtia të punës në industrinë e transportit dh për të luftuar këtë përkeqsim. Edhe Unia, anëtare e ETF-it mbështetë këtë iniciativë e fushatë dhe fton anëtarësinë me pasaportë të BE-së që të nënshkruajnë iniciativën!**



Shoferëve të kamionëve u nevojitet mbrojtje e kushte korrekte të punës

Sindikata ETF organizon punonjësit të degëve të ndryshme të industrisë së transportit: hekurudhat, transporti rrugor, komunikacioni ajror, logjistika dhe udhëtimet detare, si dhe peshkatarinë e turizmin. Degë

të rëndësishme këto, pasi shtrohet pyetja se si do të udhëtonim me tren nga një qytet në tjetrin pa drejtues (shofer) treni, si do vinin pemët e perimet tona pa këta njerëz, si do të ishin pushimet tona pa këto punë!

**Shfrytëzimi dhe pasiguria rriten me ritëm të shpejtë**

Por në BE po ndodhin gjithnjë e më shumë raste dumpingu social dhe ai në paga. Punëdhënës të caktuar shfrytëzojnë punëmarrësit, veçanërisht migrantët: atyre u duhet të punojnë më rëndë, më gjatë, më shpejtë dhe atë për më pak para dhe me më pak rrjete të sigurisë kontraktuale. E gjithë kjo paraqet rrezik të punëmarrësit dhe rezik edhe për sigurinë në rrugë e komunikacion.

**Nevojiten kushte korrekte pune!**

ETF dëshiron të ndryshojë ketë gjendje, andaj edhe ka nisur iniciativën dhe fushatën qytetare evropiane. Iniciativat qytetare evropiane janë të vlefshme nëse mblidhen 1 milion nënshkrime të qytetarëve të BE-së, e të cilat përbëhen nga së paku 7 vende të ndryshme të BE-së. Një iniciativë e tillë detyron komisionin evropian që të ndërmerr ndryshime evropian për të plotësuar kërkesat e iniciativës. Iniciativa për transport korrekt kërkun posaçërisht meka-

nizma kontrollues dhe zbatues, për të siguruar implementimin e ligjeve ekzistues dhe kështu të garantohen kushte pune korrekte dhe të njëjta në degët e industrisë së transportit.

**Qytetarë të BE-së: Nënshkruani tani!**

Dumpingu social na prek në të gjithë, andaj edhe jemi të ftuar të gjithë ta luftojmë atë. Është në interes të të gjithë neve që shoferët ti përmbahen kohës së tyre të pushimit dhe e ata me pagën e tyre të kenë mundësi të bëjnë një jetë me dinjitet. Andaj Unia fton anëtarësinë në vijim:

- Shkoni tek faqja e internetit: [www.fairtransporteurope.eu](http://www.fairtransporteurope.eu)
- Shkoni në fund tek formulari dhe përgjigdhni gjuhën dhe vendin
- Plotësojeni formularin në tërësi
- Postojeni në Facebook apo Twitter dhe shpërndajeni dhe përhapeni më tej.

© Aurora Garcia

**Tregtimi online**

**Për tregtinë në internet nevojitet KKP**

**Tregtia në internet dhe me porosia m postë elektronike është duke lulëzuar. Mirëpo kushtet e punës në këtë sektor janë mjaft problematike e pagat shumë të vogla. Andaj, delegatët e këtij sektori të tregtisë me pakicë të Unias kërkojnë nga punëdhënësit sigurimin e një Kontratë kolektive të punës (KKP) të mirë dhe të vlefshme edhe për tregtinë-online.**

Gjithnjë e më shumë prodhime e shërbime në ditët e sotme blihen përmes internetit, posaçërisht në fushën jo-ushqimore, si multimedia/

elektronikë dhe të modës. Mirëpo lulëzimi ka edhe një anë tjetër, e cila paraqet ngarkesë për të punësuarit: stres dhe presion në punë në qendrat logjistike dhe web-shitoret të shtëpi-ve shitëse përmes postës elektronike, apo dumpingu pagë për këshilltarët/et e modës sa vijnë e rriten.

**Kushte të pasigurta të punës**

Shumica e të punësuarve kanë kushte të pamjaftueshme pune dhe pagash. Rasti i tregtuesit online Outfitferry, i cili donte të paguante page prej vetëm 2500 frangave, është vetëm një shembull. Mirëpo ky shembull tregon se: Në industrinë tregtare-

**Nevojiten KKP të mira**

Përmes një rezolutë pjesëmarrësit e konferencës së delegatëve të industrisë ë tregtisë kërkojnë nga ndërmarrjet që të përmirësojnë kushtet punës dhe që ato të sigurohen e garantohen përmes KKP (Kontratave Kolektive të Punës) të mira. Aty ku



Shitoret-online janë duke lulëzuar në kurriz të punëmarrësve

online që është duke lulëzuar ka nevojë për rregulla të detyrueshme, për të siguruar mbrojtje korrekte për të punësuarit.

**Solidarizim me të punësuarit në Amazon**

Pos kësaj delegatët e Unia-s u solidarizuan me kolegët/et grivist të Amazon në Leipzig dhe Graben (Gjermani). Këta janë duke luftuar për kontratë kolektive me kushte të mira pune dhe paga që sigurojnë ekzistencën.

© Osman Osmani

**Revidimi Ligjit për Azil, njëri nga 6 projektligjet**

**Votimet federale të 5 qershorit 2016**

**Më 5 qershor 2016 mbahen votimet federale të radhës. Votuesit do të vendosin për 6 çështje: Në vijim ne do ti përshkruajmë shkurt tri nga më të rëndësishmet si dhe do të bëjmë të njohur edhe rekomandimin e sindikatave për to.**



**Iniciativa popullore «për financim korrekt të komunikacionit» («Iniciativa-loba qumësh të dhënësë»)**

Iniciativa në fjalë është lansuar nga shoqatat automobilistike (ASTAG, auto-schweiz, TCS, ACS) dhe shoqatës së zejtarëve. Për fushatën votuese si duket janë në dispozicion shumë para, përfllitet për një buxhet prej 7 milion frangave. Iniciativa dëshiron që tërë të ardhurave nga tatimi në mineralet dhe vajrat të shkojnë për financimin e rrugëve. Ajo në fund përcaktimi listën e përdorimit të të ardhurave nga tatimi në mineralet dhe vajrat dhe nga vinjeta për autostradë, gjegjësisht për rrugët nacionale; ctytjen dhe zhvillimin e komunikacionit të kombinuar, infrastrukturën rrugore nëpër qytete dhe aglomerat; rrugët kryesore dhe ato kantonale; ndërtimet mbrojtëse dhe mbrojtje të pasazhit në kontekst të komunikacionit rrugor. Më tej do të duhej që futja dhe rritja e tatimit dhe të hyrat tjera e taksat nga fusha e komunikacionit rrugor gjithmonë ti nënshtrohen referendumit fakultativ. JO për iniciativën-loba qumësh të dhënësë. Ne kemi nevojë për para për arsimim dhe kulturë në vend të peizazheve të betonuara.

© Osman Osmani

**Apeli për të pranuar 50 000 refugjatë**

**Një gjest i vogël njerëzor**



Pamje nga demonstrata e 9 prillit 2016 në Bernë

**Që nga lufta e dytë botërore nuk kemi pasur kaq shumë njerëz në ikje. Me mijëra janë duke humbur jetën gjatë ikjes. Ne nuk duhet të shohim duarlidhur këtë katastrofë humanitare! Andaj Unia mbështetë Apelin për pranimin e 50 000 refugjatëve në Zvicër.**

60 milion njerëz janë larguar nga shtëpitë dhe mjedisit e tyre i besueshëm dhe një pjesë në Evropë të gjejnë një jetë më të mirë. Mirëpo me mijëra nuk arrijnë qëllimin e tyre, porse humbin jetën gjatë rrugëtimit. Kështu vetëm në vitin 2015 kanë humbur jetën rreth 800 veta. Situata është urgjente: në vitin 2015 nga një krizë humanitare kanë qenë të prekur 250 milion njerëz.

**Pak mbështetje nga përgjegjësit**

Nga përgjegjësit refugjatët marrin pak mbështetje. Në vend se të hapen rrugë të sigurt, për të mos pasur ne-

format shfrytëzuese ekonomike, të cilat favorizojnë mirëqenien e vendeve evropiane. Zvicra eksporton rregullisht material luftarak në viset e luftës dhe kështu bëhet bashkëpërgjegjëse. nevojitet një zgjidhje e qëndrueshme e konflikteve dhe luftim serioz të shkaqeve e ikjes!

**Pranimi i refugjatëve i gjest njerëzor**

Aktualisht rreth 50000 njerëz qëndrojnë të shtrënguar në kushte të mjerueshme në Greqi: Zvicra do të duhej të vepronte në traditën dhe përgjegjësinë e saj humanitare. Andaj ne kërkojmë që Zvicra të pranojë 50000 refugjatë, para së gjithash ata më të lëndueshmit – fëmijët dhe të rinjtë e pashoqëruar, të sëmurët, gratë shtatzëna. Pasi ashtu si kërkohet në Apel «Vuajtjet enorme, në të cilat jetojnë refugjatët, në emër të njerëzimit, nuk mund të injorohen edhe më tej».

© Marilia Mendes

**Të ndalet lufta, shtypja e shfrytëzimi – e jo njerëzit**  
Shkaqet globale të ikjes shpesh janë të ndërlihdura drejtpërdrejti me

**Intervistë**



Diana Hinz, organizatorja e demonstratës së 9 prillit

**«Unë angazhohem për refugjatë shkaku i fëmijëve të mijë»**

**Diana Hinz jeton në Kanton Aargau dhe është nënë e dy fëmijëve. Me bashkëshortin dhe dy fëmijët e tyre ajo vitin e kaluar për dy javë ishte në ishullin grek Samos ku aktivisht u angazhua për të ndihmuar refugjatët. Pas kthimit në Zvicër ajo organizoi manifestimin «Bashkë për një Evropë njerëzore», i cili manifestim u zhvillua më 9 prill 2016 në sheshin federal të Bernës.**

**Diana, ti bashkë me persona tjerë privat kenit organizuar demonstratë në Bernë. Çka të ka shtyrë për të bërë këtë?**

Pafuqia ime dhe mungesa e mirëkuptimit për politikën evropiane kundrejt refugjatëve. Unë e kam parë se si e ndjenin veten njerëzit në Greqi. Ishte tronditëse! Pas kthimit këtu ndihesa sikur e propozor. Pamjet e njerëzve të përvojatur nuk më lenin më të qetë. Unë jam njëri i drejtësisë. Mirëpo unë edhe e kam parë se drejtësia në Evropë nuk vlen për të gjithë. Unë nuk mund ta pranoi një gjendje të tillë!

**Çka ka qenë ajo që të ka tronditur aq shumë në Greqi?**

Gjendja në të cilën vinin njerëzit nga Turqia. Ishte tetor, jo edhe aq ftohtë. Mirëpo njerëzit ishin të dobët, të uritur dhe me shëndet të dëmtuar. Unë kam parë fëmijë me lëkurë të skuqur e të infektua, njerëz me probleme në të parë, njerëz të ftohur keq. Dhe mungonin të gjitha: ilaçet, artikuajt higjienik, nganjëherë edhe ushqimi. Para së gjithash mungonin qumështi dhe artikujt ushqimor për bebe, që atje ishin shumë të shtrenjta. Një fatkeqësi!

**Përse ke organizuar demonstratë në vend se të angazhohesh në ndonjë shoqatë bamirëse?**

Shumë organizata të vogla dhe shumë vullnetarë janë duke bërë punë të madhe dhe të rëndësishme atje ku janë refugjatët. Mirëpo ata nuk mendojnë të bëjnë më shumë se sa ta lehtësojnë situatën. Rrugët e rrezikshme të ikjes, strehimi i pa dinjitet dhe i dëmshëm për shëndetin, marrëveshja me Turqinë... Pranimi i refugjatëve në Zvicër është shumë më efektive dhe më njerëzore.

Mirëpo kjo nuk është e tëra. Unë angazhohem edhe shkaku i fëmijëve të mijë. Pasi ia shroj vetes pyetjen se në çfarë bote dua që të rriten fëmijët e mijë. Sigurisht, jo në një botë, në të cilën drejtat e njeriut nuk vlejnë për të gjithë njerëzit. Andaj unë angazhohem për një Evropë me drejtësi. Për këtë luftoj unë. Nëse ne tani nuk luftojmë për këtë çështje, në të ardhmen këtë do ta paguajnë fëmijët tanë.

**Si e mendon ti këtë?**

Nëse ne lejojmë sot që të gjithë njerëzit mos të kenë qasje në drejtësi, nëse ne lejojmë përjashtime, atëherë është e mundur që ne -apo fëmijët tanë – në të ardhmen nuk do të mund të mbrohën nga shtypja. Unë dua për fëmijët e mijë një jetë ku të drejtat e njeriut të jenë të vetëkuptueshme. Për të gjithë. Si reagan njerëzit në Zvicër në idenë për demonstratë? Shumë njerëz sikur kanë pritur një gjë të tillë. Disa nga kontaktet e mijja në Facebook sikur këngëtarja e xhazit Birgit Ellmerer, menjëherë reagan si zjarri në flakë. Kështu unë thjeshtë e rezervova sheshin federal dhe brenda 3 javësh e organizuam demonstratën. Ne ishim tërësisht të papërvuajë, mirëpo megjithatë gjithçka shkoi mirë dhe ishte për mrekulli!

**Dhe tani, si do të vijoni më tej?**

Ne duhet të mobilizojmë edhe njerëz tjerë, duhet të krijohet një lëvizje. Me njerëz, për të cilët është me rëndësi një Zvicër e drejtë me një politikë të hapur refugjatësh, e të cilët do të duhej të takoheshin rregullisht, fala bie çdo të premtë në mbremje dhe për tu shprehur mbi këtë çështje. Për të arritur më shumë njerëz të cilët janë të gatshëm të ngritën në këmbë për të drejta të njeriut dhe drejtësi.

© Marilia Mendes





Angazhim i gjithanshëm për mbrojtjen e pensioneve dhe fuqizimin tyre përmes AHV/AVSplus

Iniciativa federale AHV/AVSplus

# AHV/AVSplus... për pensione më të mira

**Problematike: pensionet e ulëta**

Shumë pensionist/e në moshën e pensionimit nuk mund të pushojnë e gjejnë prehje, apo të ndërmarrin gjëra për të cilat gjatë jetës profesionale nuk kanë pasur kohë dhe mundësi të bëjnë. Edhe më tej atyre ju duhet të rropaten me problemet financiare. Pasi për shumë pensionist/e pensioni nuk u mjafton për një jetë me dinjitet.

Për të prekurit kjo domethënë: Edhe përkundër asaj se gjete tërë jetës së tyre ata kanë punuar rëndë, pas pensionimit atyre ju duhet që për çdo frang ta mendojnë mirë disa herë para se ta lëshojnë nga dora. Dhe këtë jo vetëm nga fakti: pasi nuk mund të sigurojnë vetes standard jetësor zviceran, ata janë të kërcënuar edhe nga izolimi social.

**Zgjidhja: AHV/AVSplus**

Për të korrigjuar këtë mizëri, pensionet e pleqërie AHV/AVS duhet të rriten. Pikërisht këtë e kërkon edhe AHV/AVSplus. Kështu ndërtohet koncepti mbi modelin e suksesit AHV/AVS, i cili një çmim të ulët për shumicën e qytetarëve të saj siguron një performancë të mirë.

Në mbledhjen e delegatëve të SGB (Bashkimit të Sindikatave Zvicerane) të datës 16 nëntor 2012 konceptit të AHV/AVSplus i dha formë konkrete dhe në gjysmën e parë të vitit 2013 i lansua iniciativa popullore AHV/AVSplus, për të rritur pensionet e pleqërisë AHV/AVS për 10%. Për vetëm 4 muaj ishin mbledhur më shumë se 100000 nënshkrime me çka u arrit që të hidhet në votim. Në sesionin dimëror të vitit 2015 parlamenti nacional i pat propozuar këshillit të dhomës së kantoneve refuzimin e iniciativës. Fjalën e fundit do ta ketë populli në vitin 2016.

Kushtetuta federale kërkon që pensionet e AHV/AVS dhe Sigurimit Pensional profesional bashkë duhet të mundësojnë «Vazhdimi i standardit të mëparshëm të jetesës në mënyrën e arsyeshme». Sot ky qellim nuk mund të arrihet tek shumë njerëz. Kjo nuk prek vetëm njerëzi që pas pensionimit llogarisin vetëm në një pension nga AHV/AVS. Edhe shumë njerëz që marrin pension nga shtylla e parë dhe e dytë e sigurimeve shoqërore nuk arrijnë kuotën që parashihet me kushtetutë. Ky fenomen mund të ashpësoj duke pasur parasysh presionin që është duke iu bërë shtyllës së dytë. Andaj pensionet e AHV/AVS duhet të rriten.



Pamje e krijuar në takimin e sekretareve/ëve të Unia-s

**Rritje për 10%**

Bashkimi i Sindikatave Zvicerane (SGB) në iniciativën e saj propozon që pensionet AHV/AVS të rriten në mënyrë lineare për 10%. Në një pension minimal aktual prej 1160 frangave për një person të vetëm do të paguhej një shtesë prej 116 frangave. Tek një pension maksimal prej 2320 frangave do të ishin 232 franga më shumë, ndërsa tek një pension i plotë i bashkëshortëve rritja do të ishte për 348 franga. Këto shtesa do të lehtësonin të prekurit dukshëm. Një hedhje syri ndarjes së pensioneve të sotme, tregon se gratë – veçanërisht prindër e vetme – do të përfitonin më shumë nga rritja.

Amvisnit mostër	Paga e fundit (pa pagën e 13-të)	Pensioni AHV/AVS	Shtesa AHV/AVSplus
Punëtorë ndërtimtarie & luleshitëse (60%), 2 fëmijë	Fr. 4800.- Fr. 2400.-	Fr. 3480.-	Fr. 348.-
Kopshtar & kameriere (40%), 2 fëmijë	Fr. 4000.- Fr. 1600.-	Fr. 3200.-	Fr. 320.-
Bukëpjekës	Fr. 4500.-	Fr. 1780.-	Fr. 178.-
Infermiere (80%), 1 fëmijë, beqare	Fr. 5000.-	Fr. 2050.-	Fr. 205.-
Kryepunëtor, me 30 vjet i ardhur në Zvicër	Fr. 6300.-	Fr. 1620.-	Fr. 162.-

Shembujt të rritjes së kërkuar të pensioneve AHV/AVSplus

**Financimi**

AHV/AVSplus është e ndërlidhur me një lartësi shume prej 3,6 miliard franga. Iniciative nuk parasheh rregulla financimi. Si burime financimi vijnë në konsideratë të ardhurat nacionale nga tatimi i trashëgimive, sikur kërkon një iniciativë e mbështetur nga SGB-ja. Me mbledhjen tatimore të trashëgimisë nga 2 milion franga në sigurimin Pensional të AHV/AVS do të rridhnin deri në 2 miliarda më shumë të hyra.

**AHV/AVS Broshura**

Gjithçka e doni të dini mbi AHV/AVS mund të mësoni në broshurën tonë «AHV/AVS. Një përkujdesë pleqërie për të rinj dhe pleq». Broshurën si E-libër apo për të shkarkuar në vegën vijuese: [www.sgb.ch/fileadmin/user\\_upload/DE\\_20150818\\_SGB\\_AHV-Brosch\\_eBook\\_korr.pdf](http://www.sgb.ch/fileadmin/user_upload/DE_20150818_SGB_AHV-Brosch_eBook_korr.pdf)



© Osman Osmani



## Ju pyesni, Unia përgjigjet

### Në pushim mjekësor: A duhet megjithatë të lajmërohemi si i papunë?

**Shefja ime më ka pushuar nga puna, pasi unë për një kohë të gjatë isha i paafte për punë. Unë kam qenë në vazhdimësi 100% në pushim mjekësor me vërtetim mjekësor: Në fund të afatit të pushimit nga puna desha të lajmërohem tek Enti regjional për ndërmjetësim pune (RAV) si i papunë. Për befasinë time mua më thanë të kthehem në shtëpi me arsyetimin se unë isha i pa ndërmjetësuar për punë, andaj edhe nuk mund të regjistrohesha si i papunë. Në këto rrethana unë edhe ashtu nuk do të marr paratë e sigurimit në rast të papunësisë. A qëndron kjo?**

**Jo.** Edhe pse tani për tani nuk mund të punoni, ju duhet të lajmëroheni tek RAV-i dhe të dorëzoni dokumentacionin Arkës për të papunët. Vetëm kështu siguroheni që e drejta dhe kërkesa e juaj të llogaritet si duhet. Arka është e obliguar të përcaktojë pikërisht datën në të cilën ju jeni lajmëruar. Ndërsa sa para ju do ti merrni varet ndër të tjera edhe nga ajo se sa muaj keni punuar në vitet e fundit para se të lajmëroheni në RAV. Nëse lajmëroheni pasi të mos keni qenë edhe më tej në pushim mjekësor, atëherë humbni të drejtën e parave ditore. Nëse fjala bie ju jeni lajmëruar tek 8 muaj pas përfundimit të marrëdhënies në punë, ju do të keni të drejtë në 260 ditë kompensimi në vend të 400 ditëve.

Michael Schweitzer, work, 17.3.2016

### Mjekja e besueshme: A duhet të respektoj terminin tek ajo?

**Momentalisht psikikisht jam për toke. Shoqja ime më ka lënë. Pos tjerash jam lënduar dhe për këtë arsye nuk mund të luaj as futboll. Ka tri javë nuk mund të punoj më. Mjeku im shtëpiak më ka dhënë vërtetim për pushim mjekësor. Shefi im çka është e vërteta nuk i din arsyet pse unë jam në pushim mjekësor. Tani ai më thotë se unë duhet të shkoj tek mjekja e besueshme e tij, përndryshe nuk do të vazhdojë të ma paguajë pagën. Unë nuk dua që shefi im të mësojë për problemet e mija private. Pos tjerash unë nga koha në kohë kam konsumuar edhe drogë, për t'ia lehtësuar vetes problemet aktuale të kohëve të fundit. Unë jam duke u merakosur që mjekja e besueshme do ti tregoi shefit. A duhet që unë të shkoj tek ajo?**

**Po,** ju duhet ta bëni këtë. Shefi juaj mund t'ju dërgoi tek mjekja e besueshme e tij, nëse ai ka dyshim mbi sëmundjen e juaj. Nëse nuk shkoni tek ajo, atëherë ju lëndoni të ashtuquajturin besim të obligueshëm kundrejt firmës, dhe shefi juaj guxon tua ndërpresë pagesën. JU nuk keni pse të merakoseni: Ju mund t'ia tregoni mjekes së besueshme të gjitha. Ajo, sikur edhe të gjithë mjekët tjerë është e obliguar të respektojë fshehtësinë profesionale. Ajo guxon të informojë shefin tuaj vetëm se a jeni i sëmurë, sa kohë do të jeni përafërsisht edhe më tej i sëmurë dhe se cilat punë nuk mundeni dhe nuk duhet ti kryeni derisa jeni i sëmurë. Mjekja e besueshme nuk guxon ti tregojë shefit tuaj as diagnozën as arsyet e sëmundjes suaj. Pra, shefi juaj nuk do të mësojë asgjë për çështjet tuaja private.

David Aeby, work, 3.3.2016

Impressum: Beilage zu den Gewerkschaftszeitungen work, area, Événement syndical | Herausgeber work, Gewerkschaft Unia, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | Redaktionskommission A. García, A. Rogalewski, D. Filipovic, E. Sariasslan, M. Martin, M. Mendes, O. Osmani | Sprachverantwortlich Osman Osmani | Layout C. Lonati, Unia | Druck Tagblatt Print, Im Feld 6, 9015 St. Gallen | Adresse Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft. Le Syndicat. Il Sindacato.